

Ibadeti (adhurimi)

العبادة

< Shqip – Albanian – ألباني >



Abdullah Ahmed El-Huvejl

عبد الله بن أحمد الحويل



Përktheu: Jusuf Kastrati

ترجمة: يوسف كاستراتي

IBADETI (ADHURIMI)

Përkufizimi:

Fjala *ibadet* (عبادة) gjuhësisht domethënë *përvulje* dhe *nënshtrim*.

Ndërsa në terminologjinë fetare fjala *ibadet* ka kuptimin: Emër i përgjithshëm për çdo gjë që e do Allahu, qofshin ato fjalë a vepra, të dukshme ose të padukshme.

Shkaku i emërimit të detyrave fetare kundruall robërve ibadete:

Ngase ata u përmbahen këtyre detyrave dhe i kryejnë ato duke qenë të përvulur dhe të nënshtruar kundrejt Allahut.

Shtyllat e ibadetit:

1. Dashuria (محبة).
2. Frika (خوف).
3. Shpresa (رجاء).

Kushtet e vlefshmërisë dhe pranimit të ibadeteve:

1. Ihlasi (çiltëria):

Argument për këtë është thënia e Allahut:

﴿وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ﴾

﴿E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit).﴾¹

2. Pasimi i pejgamberit Muhamed ﷺ:

Argument për këtë është thënia e të dërguarit të Allahut, Muhamedit ﷺ: “Kushdo që shpik në çështjen tonë (fenë tonë) diçka që nuk është prej saj, ajo gjë është e refuzuar.”²

¹ Sureja el-bejjine, 5.

² Muttefekun alejhi.

Ibadeti është dy llojesh:

1. Ibadet natyror (عبادة كونية).
2. Ibadet shariatik (عبادة شرعية).

Ibadeti natyror:

Përkufizimi: Ibadeti natyror është nënshtrimi ndaj ligjeve që i ka bërë Allahu në natyrë. Ky lloj ibadeti i përfshin të gjitha krijesat, qofshin besimtarë a jobesimtarë, të devotshëm a gjynahqarë.

Argument për këtë është thënia e Allahut:

﴿إِنَّ كُلَّ مَنْ فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ إِلَّا آتِيَ الرَّحْمَنِ عَبْدًا﴾³

«S'ka krijesë që gjendet në qiej dhe në Tokë e që të mos vijë si rob para të Gjithëmëshirshmit.»³

Ibadeti shariatik:

Përkufizimi: Ibadeti shariatik është nënshtrimi ndaj urdhrave fetarë të Allahut.

Ky lloj ibadeti është i veçantë për atë që i bindet Allahut dhe pason atë me të cilën kanë ardhur të dërguarit.

Argument për këtë është thënia e Allahut:

﴿وَعِبَادُ الرَّحْمَنِ الَّذِينَ يَمْشُونَ عَلَى الْأَرْضِ هَوْنًا﴾

«Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë.»⁴

RREGULL E RËNDËSISHME PËR NJËSHMËRINË E IBADETIT**Rregulla:**

“Çdo vepër që është ibadet, nëse i kushtohet Allahut është Teuhid, ndërsa nëse i kushtohet dikujt tjetër pos Allahut është shirk.”

Argument për këtë rregull i kemi thëniet e Allahut:

﴿وَأَعْبُدُوا اللَّهَ وَلَا تُشْرِكُوا بِهِ شَيْعًا﴾

³ Sureja Merjem, 93.

⁴ Sureja el-Furkan, 63.

﴿Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim).﴾⁵

﴿وَقَضَىٰ رَبُّكَ أَلَّا تَعْبُدُوا إِلَّا إِيَّاهُ﴾

﴿Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuroni askënd tjetër përveç Atij.﴾⁶

﴿قُلْ تَعَالَوْا أَتْلُ مَا حَرَّمَ رَبِّيَ عَلَيْكُمْ عَلَىٰ كُمِ إِلَّا تُشْرِكُوا بِهِ شَيْئًا وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا﴾

﴿Thuaju: “Ejani t’ju lexoj çfarë ju ka urdhëruar Allahu: që të mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim).﴾⁷

Shembuj:

- Duaja është ibadet, —————> nëse i kushtohet dikujt tjetër përveç Allahut është shirk.
- Frika është ibadet, —————> nëse i kushtohet dikujt tjetër përveç Allahut është shirk.
- Zotimi është ibadet, —————> nëse i kushtohet dikujt tjetër përveç Allahut është shirk.
- Therja e kurbanit është ibadet, —————> nëse i kushtohet dikujt tjetër përveç Allahut është shirk.

⁵ Suretu en-nisa, 36.

⁶ Sureja el-isra, 23.

⁷ Sureja el-en’am, 151.

